

343.61 (497.115)

Mr.asc. Fitim Bekteshi<sup>1</sup>

**KRIMET KUNDËR JETËS NË ASPEKTIN KRAHASUES  
NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

**ЗЛОСТОРСТВОТА ПРОТИВ ЖИВОТОТ ОД СПОРЕДЕН  
АСПЕКТ ВО РЕПУБЛИКА КОСОВО**

**CRIMES AGAINST HUMAN IN R. OF KOSOVO IN  
COMPARATIVE PERSPECTIVE IN KOSOVO**

**Abstract**

In this scientific paper entitled “Crimes against human in comparative terms in R. of Kosovo,, it comes to research on serious crimes against human in individual aspect and will be based on data for three types of criminal offenses such as: murder, attempted murder and manslaughter, as one of the most important factors of threaten endangering human security and human life, at local, national, regional as well as international of the contemporary society in comparative scientific standpoint.

The threat to human life is one of the largest that world has ever faced throughout history with tendency of development at a tremendous pace. Through this paper I will try to give an explanation and risk analysis of this phenomenon that is increasing the number of serious crimes against human life and body. The content of the paper will be such that to some extent create an idea of what this phenomenon in view of comparative factors are affecting the extinction of human life, it came from this phenomenon standpoint historic, what was his beginnings of what is today? All these in some form tend to give a clarification on the legal viewpoint and etiological crimes against human life and body.

**Key words:** crimes against human, comparative aspect of the murders, murders, etiological circumstances of crimes against human life and body etc.

---

<sup>1</sup> Magjistër i shkencave të sigurisë dhe detektive, Prizren, Republika e Kosovës.

## 1. Kuptimi krimet kundër jetës në aspektin krahasues

Në këtë punim shkencor të titulluar: *Krimet kundër jetës në aspektin krahasues në Republikën e Kosovës*, bëhet fjalë për hulumtimin mbi krimet të rënda kundër jetës, dhe do të bazohet në të dhëna për tre grupe veprash kriminale si Vrasje; Vrasje e Mbetur në Tentativë dhe Vrasje nga Pakujdesia, si një ndër faktorët nga kërcënuesit më kryesor të rrezikimit të sigurisë njerëzore dhe jetës së njeriut si; në nivel lokal, kombëtar, rajonal po ashtu edhe atë ndërkombëtar të shoqërisë bashkëkohore në këndvështrimin krahasues shkencor.<sup>2</sup>

Kërcënimi për jetën e njeriut është ndër më të mëdhenjtë që bota ndonjëherë ka hasur gjatë historisë, dhe ai po zhvillohet me një ritëm të hatashëm. Me anë të këtij punimi unë do të provoj të japë një shpjegim dhe analizë të këtij fenomeni rrezikues që sa vjen e rritet numri i veprave penale të rënda kundër jetës dhe trupit të njeriut. Përmbajtja e punimit do të jetë e tillë, që deri në një masë të krijohet një ide se çka është ky fenomen në pikëpamje krahasuese cilët janë faktorët që ndikojnë në shuarjen e jetës së njeriut, prej nga ka ardhur ky fenomen këndvështrimin historik, çfarë ishte në fillimet e tij e çfarë është sot? Gjitha këto në një farë formë tentojnë të japin një sqarim në pikëpamje juridike dhe etiologjike të veprave penale kundër jetës dhe trupit të njeriut.

## 2. Paraqitja e veprave penale kundër jetës

Gjatë studimeve të deritanishme, më duhet të pranoj se më kanë tërhequr veçanërisht disiplinat shkencore në fushën e së drejtës penale. Por, interes të posaçëm për mua paraqet disiplina qendrore në këtë fushë të së drejtës, sikurse është e drejta penale (studimi i thelluar i instituteve themelore të saj). Bazën e përgjegjësisë penale e përbën prania e veprës penale. Ndërsa kushtin paraprak apo parakushtin e saj, e përbën përcaktimi i figurës së veprës penale konkrete, e cila parashikohet në dispozitën, konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal ose të ligjeve të posaçme penale. Është pikërisht dispozita konkrete e Pjesës së Posaçme

<sup>2</sup> Në këtë drejtim, në jurisprudencën shqiptare tepër me vlerë është vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë, nr4 datë15.04.2011, ku pas një analizë të thellë, nga një anë të elementeve përbërës të veprës penale, nga ana tjetër e parimeve bazë që rregullojnë institutin e bashkëpunimit i parashikuar nga neni 25 i Kodit Penal, gjykata arrin në konkluzionin se “kur nga pikëpamja e anës objektive provohet se vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, vepra do të konsiderohet e kryer në bashkëpunim”.

<sup>2</sup> I.Salihu., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme. Prishtinë, Tetor 2010, f. 180.

të Kodit Penal, në të cilën parashikohet lloji konkret i figurës së veprës penale në bazë të së cilës do të akuzohet personi, apo personat e dyshuar, si autorë të veprës penale.

### 3. Reagimi ndaj veprave penale kundër jetës

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i kushton një kapitull të veçantë përgjegjësisë penale, (Kreu i dytë i Pjesës së Përgjithshme të Kodit Penal në nenet 12-21). Në këtë kapitull përfshihen dy kategori dispozitash. Në kategorinë e pare, përfshihen dispozita të tilla si neni 12 i Kodit Penal, në të cilin parashikohet mosha për përgjegjësi penale për krimet dhe kundërvajtjet penale. Neni 13 i Kodit Penal që parashikon lidhjen shkakësore, e cila duhet të ekzistojë ndërmjet veprimit ose mosveprimit të autorit të veprës dhe pasojave, apo mundësisë së ardhjes së tyre. Neni 14 i Kodit Penal që parashikon fajin, në mungesë të të cilit nuk mund të dënohet askush për një veprim ose mosveprim që ligji e parashikon si vepër penale.<sup>3</sup>

Ndërsa, nenet 15 e 16 të Kodit Penal, japin karakteristikat thelbësore të të dy formave të fajit, si dashja dhe pakujdesia. Në kategorinë e dytë përfshihen dispozitat në lidhje me disa rrethana të posaçme, prania e të cilave bën që personi, i cili ka kryer një vepër penale, që formalisht duket si vepër penale, përjashtohet nga përgjegjësia penale. Të tilla janë, neni 17 i Kodit Penal, në të cilën përcaktohet kuptimi juridiko-penal i papërgjegjshmërisë për shkak të gjendjes mendore dhe, neni 18 i Kodit Penal, në të cilin parashikohen rastet e asaj, që nga disa penalistë quhet ndryshe dhe përgjegjësi penale “e kufizuar”, (sikundër janë rrethanat e kryerjes së veprës penale në gjendje të dehur ose nën efektin e narkotikëve apo simulantëve të tjerë).<sup>4</sup>

Në vargun e rrethanave, të cilat përjashtojnë përgjegjësinë penale, edhe pse vepra në dukje përmban formalisht elementet e ndonjë vepre penale, përfshihen edhe rrethana të tilla si, mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, si dhe ushtrimi i një të drejte apo përmbushje të detyrës, si dhe kryerja e veprës si rezultat i zbatimit të urdhrimit të paligjshëm. Për sa u përket çështjeve, të cilat kanë të bëjnë me kategorinë e parë të dispozitave të nenit të 2-të të Kodit Penal (të Pjesës së Përgjithshme),

<sup>3</sup>Shiko nenin 86 “Tortura”; nenin 96 “Mjekimi i pakujdesshëm”; nenin 97 “Mosdhënia ndihmë”; nenin 181/a “Moskryerja e detyrave nga organet tatimore”; nenin 248 “Shpërdorimi i detyrës”, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

<sup>4</sup> Neni 1/c paragrafi II, i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

shihet qartë, se ato parashikojnë elementë të tillë thelbësorë të përgjegjësisë penale, të cilat në një kuptim të përgjithshëm, nuk janë gjë tjetër veçse elementë përbërës, të domosdoshëm për secilën prej veprave penale që parashikohen në Pjesën e Posaçme të Kodit Penal.

Mungesa, qoftë edhe e njërit prej tyre, pasjellë doemos edhe mungesën e vetë veprës penale. Ajo që mendoj se duhet të vihet në dukje, është fakti që, nga njëra anë, pavarësisht se këto elementë janë njëlloj të domosdoshëm për praninë e veprave penale, përmbajtja dhe karakteristikat juridike të tyre nuk janë as të barabarta as edhe të njëjta për të gjitha veprat penale, të cilat përfshihen në Pjesën e Posaçme të Kodit Penal. Kurse, nga ana tjetër, ato nuk janë të vetmit elementë që duhet të plotësohen për të arritur në përfundimin nëse, në njërin ose tjetrin rast, ndodhemi para njëres ose tjetres vepër penale konkrete, (në numrin relativisht të madh të veprave të cilat ligjvënësi i konsideron vepra penale).<sup>5</sup> Siç përpiqem të argumentoj më me hollësi gjatë trajtimit të këtij punimi, dallimet jo gjithmonë gjenden në elementët e vetë veprës penale, por më së shumti, në elementët e një kategorie tjetër juridikopenale, të prejardhur pazgjidhshmërisht prej saj, veprës penale, sikundër është ajo që në doktrinën e së drejtës penale emërtohet FIGURA E VEPRËS PENALE. Janë pikërisht elementët e figurës së veprës penale, tiparet që krijojnë mundësi praktike për juristin.

#### **4. Kuptimi i veprës penale**

Pikërisht, në dispozitën konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal, në të cilën parashikohet figura e veprës penale konkrete apo lloji konkret i veprës penale, për kryerjen e së cilës do të akuzohet personi apo personat e dyshuar si autor të veprës penale, rast pas rasti gjendet edhe lloji edhe masa e dënimit penal, e cila mund të caktohet nga gjykata, nëse, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, personi i akuzuar gjendet fajtor. Por, në vetvete çfarë është figura e veprës penale? A do të konsiderohet figura e veprës penale kategori më vete e së drejtës penale, e veçantë nga kategoria tjetër e kësaj disipline të së drejtës, sikurse është vepra penale, nga e cila rrjedh, apo është plotësuese e kësaj të fundit? Pavarësisht përgjigjes, të cilat do të marrin pyetjet e mësipërme dhe, shume të tjera si këto, ajo që mendoj se duhet vënë theksi është fakti se, është pikërisht figura e veprës penale, ajo e cila

<sup>5</sup> I. Elezi., S. Kaçupi., M. Haxhia., “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, Tiranë 2009, f.87.

garanton zbatimin në praktikë të parimit universal, që në kohën e së drejtës Romake quhej, nullum crimen nullum poena sine lege, scripta (nuk ka krim nuk ka dënim pa ligj të shkruar).

Ky parim, pavarësisht ndryshimeve në formulim, është sanksionuar në kodet penale kudo, përfshirë edhe në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, në nenin 2. Sipas kësaj dispozite, “Askush nuk mund të dënohet penalisht për një veprë që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale. Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj”. Kuptohet, se me parashikimin nuk duhet kuptuar vetëm emërtimi i llojit të veprës penale, i cili nuk përfaqëson gjë tjetër veçse sintezën e elementëve përbërës të saj, por edhe përshkrime, pavarësisht formës dhe masës, të tipareve objektive dhe subjektive konkrete të veprës penale të caktuar, tërësia e të cilave nuk përbën gjë tjetër, veçse figurën e veprës penale konkrete që parashikohet në një dispozitë, të caktuar në tërësinë e dispozitave, neneve që përmban Pjesa e Posaçme e Kodit Penal. Ky parim ka gjetur pasqyrim edhe në nenin 7 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në të cilën thuhet se “1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim i cili, në çastin kur ka ndodhur, nuk përbënte shkelje sipas së drejtës kombëtare ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që do të zbatohet në çastin e kryerjes së shkeljes. 2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi fajtor për një veprim ose një mosveprim, i cili në çastin kur është kryer, ishte krim sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës të njohura nga kombet e qytetëruara.” Në ligjin material, në Kodin Penal, nuk është e parashikuar thjesht vepra penale si e tillë, por edhe lloji konkret i saj. Lloji konkret i veprës penale nuk është gjë tjetër, veçse figura e veprës penale konkrete me elementët e veçantë përbërës të saj.<sup>6</sup>

### **5. Klasifikimet e figurave të veprës penale**

Në pjesën më të madhe të dispozitave të pjesës së posaçme të kodeve penale bashkëkohore, përfshirë edhe Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, është e parashikuar në formë konkrete, shprehimisht vetëm ana objektive e figurës së veprës penale konkrete, e cila është një prej katër elementeve përbërës, të domosdoshëm të saj, objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive. Në disa të tjera, veç anës

<sup>6</sup> V.Kambovski., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme. Shkup 2010, f. 123.

objektive, është parashikuar dhe ana subjektive dhe ndonjëherë edhe subjekti.<sup>7</sup> Përshkrimi me saktësi, të anës objektive të figurës së veprës penale konkrete, para së cilës ndodhemi rast pas rasti, në dispozitën përkatëse të pjesës së posaçme të Kodit Penal, përbën garanci reale juridike për ndalimin kategorik të zbatimit të ligjit penal me analogji, si një nga parimet universale të legjislacioneve bashkëkohore, përfshirë dhe Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Përmes zbulimit të pranisë ose jo, dhe përcaktimit të elementëve të anës objektive të figurës së veprës penale në çdo rast ngjarjeje, e cila dyshohet si kriminale apo kallëzim penal, i duhet dhënë përgjigje shtatë pyetjeve të pashmangshme, të cilat shtrohen për zgjidhje në çdo proces penal si: Çfarë ndodhi? Ku ndodhi? Kur ndodhi? Kush e kreu? Me se e kreu? Si e kreu? Pse e kreu? Në punim, në formë të përmbledhur, përqendrohemi në çështje të tilla si:

✚ Vepra penale si kategoria qendrore e së drejtës penale, kuptimi sociologjiko-juridik dhe historik i veprës penale, elementët përbërës së veprës penale, faktorët përcaktues të ndryshueshmërisë në kohë të veprave që janë konsideruar si vepra penale.

✚ Figura e veprës edhe pse e lidhur pazgjidhshmërisht me veprën penale si kategori shumë e rëndësishme e së drejtës penale, elementët përbërës të domosdoshëm të figurës së veprës penale.

✚ Raporti i veprës penale, figura e veprës penale, si ka gjetur pasqyrim ky raport në disa prej kodeve penale, veçanërisht me Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.

✚ Ana objektive e figurës së veprës penale, kuptimi, elementët përbërës të anës objektive të figurës së veprës penale, ndarja ligjore dhe teorike e këtyre elementëve në elementë të domosdoshëm dhe jo të domosdoshëm, etj.

Problematika e legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë rreth masës, mënyrës dhe saktësisë së përshkrimit të elementëve të anës objektive të figurave të veprave penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, sugjerime përmirësuese bazuar në praktikën gjyqësore shqiptare dhe të huaj, si dhe përvoja përafruese të tij me legjislacione penale më të përparuar të kohës. Trajtimi dhe kuptimi i saktë i lidhjes

<sup>7</sup> Kriteret e natyrës faktike kanë të bëjnë me rrethanat e kryerjes së veprës. Prej tyre, të drejtës penale i interesojnë së pari, ato rrethanat që përbëjnë anën objektive të figurës së veprës penale dhe së dyti, rrethanat, të cilat shërbejnë për të arritur në përfundimin nëse ekziston apo jo ana subjektive e figurës së veprës penale, nëse personi ka vepruar me faj, rast pas rasti.

shkakësore, ka qenë dhe mbetet gjithnjë një çështje e nxehtë e doktrinës dhe jurisprudencës.<sup>8</sup> Ekzistenca e teorive të ndryshme mbi lidhjen shkakësore. Secila nga teoritë e ka trajtuar lidhjen shkakësore në periudha të ndryshme kohe, ka pasur të mirat dhe të metat e saj. Rëndësia e lidhjes shkakësore, në kuptimin e raportit ndërmjet shkakut dhe pasojës së ardhur nga kryerja e veprës penale. Mungesa e mosplotësimit të këtij elementi të anës objektive, pas sjell mungesën e përgjegjësisë penale të autorit të saj. Praktika ka treguar, se përcaktimi i lidhjes shkakësore në një vepër penale nga organet e procedimit, nuk është e thjeshtë, madje jo në pak raste, është keqinterpretuar.

### **6. Rëndësia e studimit të pasojës, nga pikëpamja praktike**

Rëndësia e studimit të pasojës, nga pikëpamja praktike, qëndron në faktin se, duke u nisur prej saj, bëhet dallimi ndërmjet fazave të veprimtarisë, përmes të cilave kalon vepra penale, veçanërisht, ndërmjet fazës së tentativës dhe kryerjes së plotë të veprës penale. Në disa raste, arrihet në përfundimin nëse veprimet apo mosveprimet e një personi përbëjnë ose jo një vepër penale, ekzistenca e së cilës shërben për të cilësuar veprën penale sipas njërës apo tjetrës dispozitë konkrete të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal. Në varësi të pasojës, përcaktohet edhe shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, faktor ky që ndikon në llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet ndaj personit, i cili ka kryer veprën penale. Koha, si elementët e tjerë dytësorë të anës objektive, është element plotësues, por mund të marrë dhe një vlerë të veçantë, si element përbërës i domosdoshëm i veprës penale ose si rrethanë cilësuese e figurës së saj. Sipas këtij profili, koha mund të ndikojë tek vepra penale, duke çuar në përfundime të ndryshme.

Kriteret e natyrës faktike kanë të bëjnë me rrethanat e kryerjes së veprës.<sup>9</sup> Prej tyre, të drejtës penale i interesojnë së pari, ato rrethana që përbëjnë anën objektive të figurës së veprës penale dhe së dyti, rrethanat, të cilat shërbejnë për të arritur në përfundimin nëse ekziston apo jo ana subjektive e figurës së veprës penale, nëse personi ka vepruar me faj, rast pas rasti.<sup>10</sup> Thelbësore në zgjidhjen e problemit të përgjegjësisë penale për vepra që parashikohen në ligj si vepra penale, është

<sup>8</sup> Shiko nenin 76 “Vrasja me dashje”; nenin 77 “Vrasje me dashje ne lidhje me një krim tjetër”; nenin 78 “Vrasje me paramendim”; nenin 79 “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

<sup>9</sup> Neni 13, i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Tetor 2010.

<sup>10</sup> Neni 2, i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Tetor 2010.

që personi të ketë mbushur moshën e kërkuar nga ligji, 14 vjeç për krime dhe 16 vjeç për kundërvajtjet penale në kohën e kryerjes së tyre, të ketë vepruar me faj dhe të ketë lidhje shkakësore midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave shoqërisht të rrezikshme.

Megjithëse jo i shprehur në ligj, kusht i domosdoshëm është edhe që personi të jetë i përgjegjshëm. Për përgjegjshmërinë, as për sa i përket kuptimit dhe përmbajtjes së saj, as edhe thjesht si nocion, nuk bëhet fjalë, jo vetëm në Kodin Penal, i cili është në fuqi, por as edhe në dy kodet e mëparshme. Kuptimin e këtij instituti, jo vetëm si nocion thjesht tekniko-juridik, por në radhë të parë e mbi të gjitha, si nocion shoqëror, me përmbajtje të theksuar të natyrës psikiko-psikologjike, e jep doktrina e së drejtës penale. Përcaktimi i kuptimit të veprës penale është një ndër detyrat kryesore të legjislacionit penal dhe të shkencës së të drejtës penale. Do të thotë, përcaktimi i nocionit të veprës penale, i përgjegjësisë penale dhe i sanksioneve penale përbëjnë tre çështje kryesore të cilat i shqyrton e drejta penale.

Në radhën e këtyre tre çështjeve, vepra penale zë vendin e parë sepse vepra penale shërben si bazë për përgjegjësinë penale. Kur ligjvënësi parashikon një fakt si vepër penale ka si qëllim goditjen e atyre sjelljeve njerëzore të cilat prekin të mira që kanë një vlerë themelore për të gjithë shoqërinë. Bëhet fjalë për të mira juridike, të cilat mund të jenë të drejta personale të individit, por edhe interesa të tij apo të shoqërisë.<sup>11</sup> Pikërisht për të kuptuar vlerën juridike të fakteve të parashikuara nga ligji si vepra penale në lidhje me të mirat juridike të cilat ligjvënësi synon të mbrojtë, është e nevojshme ndarja dhe analizimi shkencor i të gjithë elementëve përbërës të veprës penale<sup>12</sup>. Analizimi i veprës penale kalon doemos në ndarjen e saj në disa element që përbëjnë thelbin strukturor. Kjo është e nevojshme jo vetëm pasi lehtëson studimin e saj, por edhe për faktin se përbën një mjet solid për gjykatësin në interpretimin korrekt të ligjit penal. Vetëm me anë të një analize të thellë të elementëve përbërës të veprës penale, gjykatësi mund të jap

<sup>11</sup> Mbi rolin themelor të së mirës juridike në teorinë e përgjithshme të veprës penale është kryesore vepra e A.Rocco, *L'oggetto del reato*, Torino, 1913 dhe në vazhdim F.Bricola, *teoria generale del reato*, Nuovissimo Digesto Italiano, Torino, 1973.

<sup>12</sup> Në doktrinën botërore janë afirmuar dy modele në analizimin e strukturës së veprës penale, konceptimi i unitetit të veprës penale në bazë të të cilit vepra penale konsiderohet si një moment emocional i pandashëm dhe konceptimi analitik i veprës penale, sipas të cilit vepra penale duhet të analizohet në mënyrë racionale dhe analitike. I. Padova, 1969, f.151.



një gjykim të saktë dhe të drejtë mbi përgjegjësinë penale të një individi. Pra, studimi shkencor i strukturës së veprës penale është i nevojshëm për të verifikuar korrektësinë e vendimeve gjyqësore.

Me fjalën strukturë të veprës penale duhet të kuptuar elementët e domosdoshëm në të gjitha veprat penale. Si rrjedhojë analiza e strukturës ka të bëjë me gjetjen e elementëve thelbësor pa të cilën nuk mund të ketë vepër penale. Analiza e veçantë e secilit element të veprës penale është e nevojshme nga ana metodologjike në studimin dhe interpretimin e veprës penale. Por, për të pasur vepër penale, është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj. Në teorinë e së drejtës penale janë shfaqur mendime të ndryshme në lidhje me kuptimin e veprës penale. Së pari, vepra penale trajtohet si një fenomen juridik. Por vepra penale konsiderohet edhe si fenomen social. Si veprim apo sjellje e njeriut të caktuar nga e cila dëmtohen apo rrezikohen vlera të caktuara të shoqërisë apo të individit. Në këtë aspekt, kjo sjellje e njeriut, veprimi apo mosveprimi e cila është në kundërshtim me interesat e shoqërisë ose të individit, midis të tjerash është një manifestim i personalitetit të tij, është një shprehje e gjendjes së tij psikike në një moment të caktuar. Vepra penale konsiderohet si fenomen juridik apo fakt juridik, i cili shkakton pasoja juridike në botën e jashtme. Pra, me vepër penale në aspektin formal do të kuptojmë atë sjellje njerëzore, e cila me ligj është sanksionuar si vepër penale. Sipas këtij përkufizimi, nuk shqyrtohet se vepra penale është vepër penale kundër moralit dhe shoqërisë, por vetëm nëse ajo është e kundërligjshme.

Një përkufizim i tillë nuk parashikon se për cilat shkaqe kjo sjellje konsiderohet vepër penale, por e lidh vetëm me atë që kjo sjellje duhet të jetë e kundërligjshme. Në aspektin material, vepra penale është vepër apo sjellje e njeriut, e cila dëmton apo rrezikon vlerat elementare të njeriut, të shoqërisë dhe sistemit juridik. Bëhet fjalë për vlera jetike nga të cilat varet ekzistenca e individit dhe e shoqërisë.<sup>13</sup> Do të konsiderohet vepër penale ajo sjellje e njeriut që duhet të paraqesë rrezikshmëri shoqërore. Sipas këtij përkufizimi, kjo sjellje e njeriut, pavarësisht se është e kundërligjshme, por që nuk është e rrezikshme për shoqërinë, nuk përbën vepër penale.

---

<sup>13</sup>I.Salihu., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme. Prishtinë, Tetor 2010, f. 180.

### **7. Rrezikshmëria shoqërore, e veprës penale kundër jetës**

Siç dihet, e Drejta Penale përkufizohet si tërësia e normave juridike e cila ka për objekt studimin e veprës penale, të figurës së saj dhe të llojeve e masave të dënimit që caktohen, nga gjykata, ndaj autorëve të tyre. Nga ky përkufizim del që e Drejta Penale merret me studimin e një fenomeni të caktuar shoqëror, fenomen ky që nuk është gjë tjetër, veçse cenimi i interesave të ligjshme të shtetit dhe të individëve, përfshirë edhe personat juridik në përgjithësi. Nuk është gjë tjetër, veçse ai që quhet ndryshe edhe “fenomeni penal”. Përmbajtja e fenomenit penal përbëhet nga vlera shoqërore, cenimi i këtyre vlerave dhe reagimi i shoqërisë ndaj këtij cenimi, nëpërmjet dënimit të tyre. Mirëpo, jo cenimi i të gjitha vlerave shoqërore, përbën objekt studimi të së Drejtës Penale. Përbëjnë objekt studimi të kësaj degë të së Drejtës, cenimi i atyre vlerave, të cilat shoqëria, në një periudhë të caktuar kohe, i konsideron si vlera më të rëndësishme të saj. Pikërisht për këtë arsye, ajo i merr në mbrojtje në mënyrë të veçantë, nëpërmjet dënimit penal me llojet dhe masat e ndryshme të tij, të cilat parashikohen në ligj për personat që i cenojnë apo vënë në rrezik për t'i cenuar këto vlera.

Kurse, siç dihet, cenimi i vlerave të tjera shoqërore, më pak të rëndësishme se ato të cilat merren në mbrojtje nga e Drejta Penale, përbëjnë objekt studimi dhe merren në mbrojtje nga degë të tjera të së Drejtës. Pikërisht çmimi negativ që i bën shoqëria veprave, veprimeve ose mosveprimeve të cilat cenojnë vlera të rëndësishme shoqërore, të cilat përbëjnë objekt studimi të së Drejtës Penale, kjo degë e së Drejtës e quan rrezikshmëri shoqërore e veprës.<sup>14</sup> Meqenëse, janë marrëdhëniet shoqërore-juridike që vendosen për mbrojtjen pikërisht të kësaj kategorie vlerash në një shoqëri të caktuar, në një periudhë kohore të dhënë, ato që përbëjnë thelbin e veprës penale-objektin e saj, e Drejta Penale rrezikshmërinë shoqërore e konsideron tiparin material të vetë veprës penale. Ky tipar përfaqëson një nga elementët në të cilët gjen shprehje ana e jashtme e veprës penale dhe figurës së saj. Rrezikshmëria shoqërore e veprës është cilësi e domosdoshme e veprës penale. Në qoftë se do të mungojë kjo rrezikshmëri, atëherë nuk do të kemi vepër penale. Ky është një tipar themelor mbi bazën e të cilit ligjvënësi përcakton

<sup>14</sup>Sh.Muçi, vepër e cituar më sipër f.139. 72.

rrethin e atyre veprave të cilat në një periudhë të caktuar kohe, konsiderohen vepra penale.<sup>15</sup>

Ndryshe nga sulmi ku tiparet e tij jepen të plota, lidhur me mbrojtjen ligji shqiptar parashikon vetëm një kusht, që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit, pa e përcaktuar këtë karakter dhe këtë proporcion, gjë të cilën do të duhet ta bëjë praktika dhe teoria e së drejtës penale. Intensiteti i saj duhet të jetë i barabartë apo më pak i madh se intensiteti i sulmit, sipas ligjit të thjeshtë të lidhjes aksion-reaksion<sup>132</sup>, nëse është më i vogël sulmi nuk mund të refuzohet. Por pyetja është sa më i madh? A duhet i sulmuari të shërbehet me të gjitha forcat dhe mjetet me të cilat disponon? Nuk mund të formulohet një rregull i vetëm për të gjitha rastet, përveç konstatimit se për vlerësimin e formës dhe intensitetit të nevojshëm të mbrojtjes, vendimtare janë forma dhe intensiteti i sulmit.

Vetë sulmi, mënyra e shfaqjes së tij, mjetet e përdorura, fuqia, shkathtësia, vendosmëria dhe manifestimet e tjera psikologjike të sulmuesit si tërbimi, zemërimi, gjakftohtësia në çdo rast konkret e ndikojnë në mënyrën e mundshme të reagimit . Nëse i sulmuari nuk ka asnjë alternativë, sigurisht që mbrojtja e tij është realizuar në mënyrën e vetme të mundshme, nëse i sulmuari ka më tepër alternative në dispozicion, etj.

### Conclusion

However, for the objective assessment of attacking the fact which way or which tool has been sorely needed for protection, should be taken into consideration all the circumstances, especially the moment psychological surprise, fear or similar psychological situation, present at those situation, in which cannot expect an behavior or cool logics and reasonable protections that would respond fully the intensity of the attack. With the line or proportionate means equality or near equality between the intensity of the attack and the intensity of the counterattack, which emerges from the report that is created

<sup>15</sup>Kur flasim për autonominë e një elementi përbërës të veprës penale duhet saktësuar se duke ndjekur metodën e analizimit ekzistojnë arsye të qëndrueshme nga ana logjike dhe juridike për të dalluar një element nga një tjetër dhe për ta vlerësuar në mënyrë të izoluar, megjithatë në kuadrin e veprës penale vetëm prania e të gjithë elementëve bën të mundur ekzistencën e një vepre penale. pikërisht për këtë gjyqtari i cili thërritet në aplikimin e ligjit penal ka si detyrë të kontrollojë ekzistencën e të gjithë elementeve përbërës në faktin konkret, në rast se ndonjë element mungon duhet të shpall pafajësinë e të pandehurit.

between the weight and importance of the protected right and that vulnerable to counterattack.

The theory of Italian law based on the principle of interest measurement in determining the proportion, counterattack conducted by attacking should be smaller, equal or slightly heavier than action of the attacker. It is important that repelling the attack and defense of the right to be endangered by him with a gentle manner, regardless of the means and tools used, by tracked the way of protection with smaller effects or less harmful for the striker.

### **Bibliografia**

1. Altin Dr. Shegani „*E drejtë panel e krahasuar*” Tiranë, 2002
2. Bashkim Dr. Selmani “*Krimi i Organizuar dhe Terrorizmi ndërkombëtar*” Botues: Universiteti parë privat „FON”- Shkup, 2008.
3. Afrim Dr. Osmani “Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë–teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime” Shkup, 2010.
4. Jean Pradel & Geert Corstens & Gert Vermeulen “*E drejta penale Evropiane*” Dalloz, 2009.
5. Criminal justice system in Europe, *Evropian Institute for Crime prevention and Control* (United Nations)
6. Vesel Dr. Latifi “*Kriminalistika*” Prishtinë, 2011.
7. Ragip Dr. Halili “*Viktimologjia*” Prishtinë, 2011.
8. Ragip Dr. Halili “*Kriminologji*” Prishtinë, 2008.
9. Ergyn Qapan “*Një vështrim Islam mbi terrorizmin dhe sulmet vetëvrasëse*” Tiranë 2004.
10. Ismet Dr. Elezi & Vasilika Hysi “*Politika Kriminale*” Tiranë, 2001.
11. Rexhep dr. Gashi “*Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri*” Tiranë, 2001.

### **Kodet penale të disa shteteve ;**

- ✓ Kodi Penal i Republikës së Kosovës
- ✓ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
- ✓ Kodi penale i Republikës së Maqedonisë
- ✓ Kodi penal i Gjermanisë
- ✓ Kodi i procedurës penale të Republikës së Shqipërisë